



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**V E N D I M**  
**K.P.P.74/2020**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Enkeleda Bega	Nënkryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 13.02.2020 shqyrtoi ankesën me:

<b>Objekt:</b>	Shfuqizimin e vendimit të KVO-së mbi skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “MC Catering” shpk dhe kualifikimin e operatorit ekonomik “Nelsa” shpk në procedurën e prokurimit “ <i>Kërkesë për Propozime</i> ”, me nr.REF-46468-12-18-2019, me objekt “ <i>Blerje Mish për kafshët e Parkut Zoologjik</i> ”, me fond limit 5 382 534 lekë pa tvsh, zhvilluar në datën 30.12.2019 nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Parqeve dhe e Rekreacionit.
<b>Ankimues:</b>	“MC Catering” shpk Rruga “Pjetër Budi”, Nd.29, H.3, Ap.14 Tiranë
<b>Autoriteti Kontraktor:</b>	Agjencia e Parqeve dhe e Rekreacionit Rruga “Liman Kaba”, Parku Olimpik, Tiranë
<b>Subjekt i Interesuar:</b>	“Nelsa shpk” Lagjja Qesarak, Rruga Tirane-Dajt, Zona kadastrale 2460, me Nr.pasurie 199/32, Hyrja 1
<b>Baza Ligjore:</b>	Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 “ <i>Për Prokurimin Publik</i> ”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i

Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Komisionit të Prokurimit Publik

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

## V Ë R E N:

### I

#### *Vlerësimi paraprak*

1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar;

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar.

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik;

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

### II

#### *Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 19.12.2019 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, procedura e prokurimit “Kërkesë për Propozime”, me nr.REF-46468-12-18-2019, me objekt “Blerje Mish për kafshët e Parkut Zoologjik”, me fond limit 5 382 534 lekë pa tvsh, zhvilluar në datën 30.12.2019 nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Parqeve dhe e Rekreacionit.

II.2. Në datën 30.12.2019 autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit, objekt ankimi.

II.3. Në datën 07.01.2020 autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës, nëpërmjet sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave ku rezulton si më poshtë vijon:

- Nelsa	3,985,800	I kualifikuar
- MC Catering	4,067,560	I skualifikuar
- Eagle Cons	4,680,760	I skualifikuar

II.4. Në datën 07.01.2020 operatori ekonomik “MC Catering” shpk është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi për arsyet si më poshtë vijon:

*Kapaciteti teknik: - Nuk ploteson piken 10 per mjetet e paraqitura mjetet:*

*1. AA 201 KA kontrate qeraje eshte me afat nga 01.01.2017 – 31.12.2019 kontrate e cila eshte e perfunduar.*

*2. AA 634 LE kontrate qeraje eshte me afat nga 01.01.2018 – 31.12.2019 kontrate e cila eshte e perfunduar.*

II.5. Në datën 14.01.2020 operatori ekonomik ankimues ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor duke kundërshtuar vendimin e KVO-së për skualifikimin e ofertës së tij në procedurën e mësipërme të prokurimit në mënyrë të përmbledhur me argumentat si më poshtë:

- *Në lidhje me arsyen e skualifikimit ju sqarojmë se: Për dy mjetet kontrata e qerasë është e vlefshme deri 31.12.2019 ndërsa data e zhvillimit të procedurës është 30.12.2019 cka i bën të vlefshme të dyja kontratat e qerasë për vlerësim nga ana e KVO. Kontratat e qerasë janë me afat që do të thotë se mbas mbarimit të afatit kontrata e qerasë mund të rinovohet përsëri mes palëve ose jo në rastin konkret të dyja kontratat janë rinovuar për një periudhë tjetër kohore.*

*KVO nuk ka sesi të parashikojë nëse këto kontrata do të rinovohen ose jo në fazën e vlerësimit të dokumentave KVO ka për detyrë të bëjë verifikimin e afateve kohore të dokumentave deri në datën e zhvillimit të procedurës tenderuese, rinovimet kërkohen në momentin kur OE paraqet dosjen fizike të dokumentave përpara lidhjes së kontratës në rast shpallje fitues.*

*Është e njëjta gjë sikur në vend të kontratës së qerasë më datë 31.12.2019 të përfundonte afati i kolaudimit apo siguracionit të mjetit dhe për KVO tuaj do të ishte arsye për skualifikim dhe operatori do ishte i detyruar të rinovonte dokumentat se kështu kërkon KVO.*

*Përvec dy mjeteve sa më lart operatori ekonomik MC Catering shpk ka paraqitur në tender me gjithë dokumentacionin shoqëruar të kërkuar edhe mjetin me targë AA394RE me kontratë qeraje me afat 01.01.2019-31.08.2024. Pra në total janë paraqitur në procedurë 3 mjete me gjithë dokumentacionin e rregullt të kërkuar nga dy mjete të kërkuesit. Sa më lart pretendimi i KVO për skualifikim nuk qëndron.*

- *Për kualifikimin e shoqërisë Nelsa shpk:*

*OE Nelsa shpk nuk disponon Licencë lëshuar nga QKB me kategoritë e mëposhtme: Kategoria II.1.A (1) Prodhimi dhe /ose tregëtimi i ushqimeve në emër të tij për objektin e prokurimit. Në faqen zyrtare të QKB operatori ekonomik Nelsa nuk disponon në emër të tij QKL kategoria II.1.A për objektin e prokurimit, disponon për furrë buke dhe fruta perime por jo për mish e cila automatikisht e bën ofertues të pasuksesshëm , kjo edhe sipas rekomandimit të APP nr.10181 datë 19.11.2018 mbi hartimin e kriterëve të vecanta për kualifikim dhe specifikimeve teknike për prokurimin e produkteve ushqimore pika III.Hartimi i kriterëve të vecanta për kualifikim pika a: Në objektet e prokurimit për prodhim/përpunim dhe shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz operatori ekonomik ofertues duhet të disponojë licencë kategoria II.1.A.1 Prodhim , përpunim shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz të lëshuar nga QKB pika a.1 Për të plotësuar këtë kriter për kualifikim operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë licencën kategoria II.1.A Prodhim , përpunim, shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz në emër të tij pasi licenca duhet ti përkasë operatorit ekonomik të intersuar të ofertojë për procedurën e prokurimit të shpallur nga autoriteti kontraktor.*

- *Gjithashtu nga informacionet tona ky subjekt nuk plotëson kriteret për zhvillimin e aktivitetit për Mish informacion të cilin mund ta verifikoni zyrtarisht pranë autoriteteve kompetente AKU etj. Si mund të pretendojë KVO e autoritetit tuaj se ky subjekt do të realizojë kontratën pa qenë i licensuar për të ushtruar aktivitetin e tij kur nuk ka asnjë ambjent për ushtrimin e aktivitetit objekt i procedurës së prokurimit??*
- *OE Nelsa shpk nuk disponon thertore në pronësi ose kontratë qeraje shoqëruar me QKL si dhe leje higjieno sanitare. Jemi të bindur se operatori Nelsa shpk nuk disponon në asnjë nga format thertore të shoqëruar me dokumentacionin e kërkuar në kriteret e vecanta për kualifikim.*
- *OE Nelsa shpk nuk disponon certifikatë ISO 22000:2018 HACCP të vlefshme. Jemi të bindur se operatori Nelsa shpk nuk disponon certifikatë ISO 22000:2018 HACCP të vlefshme.*

*Jemi të bindur se kualifikimi i shoqërisë Nelsa shpk është bërë në kundërshtim me nenin 43 të LPP pasi subjekti ekonomik Nelsa shpk nuk plotëson kriteret për kualifikim të DT për këtë procedurë prokurimi.*

*Për të gjitha argumentat sa më lart kërkojmë skualifikimin e OE Nelsa shpk për mospërmbushje të kritereve për kualifikim. Jemi të bindur se kualifikimi i shoqërisë Nelsa shpk është bërë në kundërshtim me nenin 43 të LPP pasi subjekti ekonomik Nelsa shpk nuk plotëson kriteret për kualifikim të DT për këtë procedurë prokurimi.*

II.6. Në datën 20.01.2020 me shkresën nr. 35/3 prot operatori ekonomik ankimues “M.C.Catering” shpk, është vënë në dijeni në lidhje me mospranimin e ankesës nga autoriteti kontraktor ndër të tjera me argumentat si më poshtë:

- *Ju mund të rinovonit kontratën edhe pas përfundimit të saj dhe të lidhnit një kontratë të vlefshme për gjithë periudhën e kontratës objekt prokurimi. Kontrata objekt prokurimi ka afat vlefshmërie deri më 31.12.2021 gjë e cila e bën të pasigurtë AK që ju ishit të aftë të kishit mjetet e nevojshme për ekzekutimin e kontratës.*
- *Gjithashtu ju sqarojmë se mjetet e paraqitura nga ana juaj janë ATV që të gjitha mjetet ndërkohë në kriteret e vendosura në DT është kërkuar një mjet ATV dhe një mjet ATP. Në vlerësimin e bërë nga KVO ju është sqaruar që nuk plotësonit pikë 10 të DT ku kërkohet një mjet ATP nuk keni paraqitur asnjë dokument që të vërtetojë që plotësonit pikën 10 të DT.*

II.7. Në datën 24.01.2020 operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtën objekt me ankesën e paraqitur pranë autoritetit kontraktor.

II.8. Nëpërmjet shkresës nr.1214/1 prot datë 06.02.2020 protokolluar me tonën me nr.81/2 prot datë 07.02.2020 me objekt “përcjellje shkrese” nga APP, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit.

### **III**

#### **Komisioni i Prokurimit Publik**

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, dokumentave të dërguara nga autoriteti kontraktor,

#### **Arsyeton**

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “MC Catering” shpk mbi kundërshtimin e skualifikimit të ofertës së tij me arsyetimin se “*Kapaciteti teknik: - Nuk plotëson piken 10 per mjetet e paraqitura mjetet:*

1. AA 201 KA kontrate qeraje eshte me afat nga 01.01.2017 – 31.12.2019 kontrate e cila eshte e perfunduar.

2. AA 634 LE kontrate qeraje eshte me afat nga 01.01.2018 – 31.12.2019 kontrate e cila eshte e perfunduar”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1. Në shtojcën 8 “Kriteret e vecanta të kualifikimit” pika 2.3 “Kapaciteti teknik” të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

1. *Mjete transporti ATP (1 mjet) ne pronesiose me kontrate qeraje, te vertetuar me:*

- *leje qarkullimi,*
- *siguracion,*
- *taksat e mjetit,*
- *leje e transportit që leshohet nga Bashkia,*
- *kontroll i mjetit,*
- *leje higjeno-sanitare,*
- *çertifikate pronësie.*

*(dokumentacioni i kerkuar te jete i vlefshëm ne perputhje me dispozitat ligjore në fuqi)*

2. *Mjeti frigoriferik ATV (1 mjet) ne pronesi ose me kontrate qeraje, të vëtetuara te me:*

- *leje qarkullimi,*
- *siguracion,*
- *taksat e mjetit,*
- *leje e transportit që leshohet nga Bashkia,*
- *kontroll i mjetit,*
- *leje higjeno-sanitare,*
- *çertifikate pronësie.*

*(dokumentacioni i kerkuar te jete i vlefshëm ne perputhje me dispozitat ligjore në fuqi)*

III.1.3. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton se operatori ekonomik ankimues ”MC Catering” shpk në përmbushje të kriterit sa më sipër ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

- Kontratë Qeraje Nr.64 Rep Nr.27 Kol datë 20.01.2017 lidhur ndërmjet S.P në cilësinë e qeradhënësit dhe ”MC Catering” shpk në cilësinë e qeramarrësit me objekt dhënia me qera e një mjeti - Lloji ATV me targa AA201KA me afat

01.01.2017-31.12.2019 shoqëruar me leje qarkullimi, Akt Miratimi Higjeno Sanitar Nr.33-Automjet Transporti Frigoriferik AA201KA, Certifikatë pronësie, Certifikatë Nr.005 datë 28.02.2017 Për transport mallrash për të tretë dhe me qera brenda vendit, Policë sigurimi, Taksa Vjetore, Certifikatë e kontrollit teknik.

- Kontratë Qeraje Nr. 1754 Rep Nr.510 Kol datë 10.10.2019 lidhur ndërmjet I.D në cilësinë e qeradhënësit dhe "MC Catering" shpk në cilësinë e qeramarrësit me objekt dhënie me qera e një mjeti shoqërisë "MC Catering" shpk - Mjeti i llojit ATV me targa AA394RE me afat 01.09.2019-31.08.2024, shoqëruar me Certifikatë e Pronësisë së Mjetit Rrugor, Leje Qarkullimi, Akt Miratimi Higjeno Sanitar, Certifikatë e Kontrollit Teknik, Policë Sigurimi, Taksa Vjetore e Mjetit.
- Kontratë Qeraje Nr.112 Rep Nr.53 Kol datë 22.01.2018 lidhur ndërmjet shoqërisë Delta Doni shpk në cilësinë e qeradhënësit dhe "MC Catering" shpk në cilësinë e qeramarrësit me objekt dhënia me qera e një mjeti shoqërisë MC Catering shpk - lloji ATV me targa AA634LE me afat 01.01.2018-31.12.2019, shoqëruar me Leje qarkullimi, Certifikatë Pronësie, Akt Miratimi Higjeno Sanitar Nr.216, Certifikatë Nr.004 datë 28.02.2017 Për transport mallrash për të tretë dhe me qira brenda vendit, Certifikatë e Kontrollit Teknik, Policë Sigurimi, Taksa Vjetore.

III.1.4. Në nenin 46, pika 1, gërma "b" të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "*Për prokurimin publik*", i ndryshuar, parashikohet shprehimisht: "*Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese.*" *Aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës*"

III.1.5. Në nenin 53, pika 3 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "*Për prokurimin publik*", i ndryshuar, parashikohet: "*Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...*".

III.1.6. Referuar sa më sipër KPP konstaton se në kriterin e vecantëtë kualifikimit autoriteti kontraktor ka kërkuar disponimin e kapaciteteve teknike lidhur me mjetet: *Mjete transporti ATP (1 mjet) ne pronesiose me kontrate qeraje, te vertetuar me:leje qarkullimi, siguracion,taksat e mjetit, leje e transportit që leshohet nga Bashkia, kontroll i mjetit, leje higjeno-sanitare, çertifikate pronësie. (dokumentacioni i kerkuar te jete i vlefshëm ne perputhje me dispozitat ligjore në fuqi)*

*Mjeti frigoriferik ATV (1 mjet) ne pronesi ose me kontrate qeraje, të vëtuara te me: leje qarkullimi, siguracion,taksat e mjetit, leje e transportit që leshohet nga Bashkia, kontroll i mjetit, leje higjeno-sanitare, çertifikate pronësie. (dokumentacioni i kerkuar te jete i vlefshëm ne perputhje me dispozitat ligjore në fuqi)*

III.1.7. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik “MC Catering” shpk KPP konstaton se në përmbushje të këtij kriteri ankimuesi ka paraqitur kontrata qeraje me subjekte të ndryshme të lidhura para noterit për mjetet e kërkuara të pajisura me dokumentacionin e nevojshëm ligjor sikundër kërkuar në dokumentat e procedurës së prokurimit objekt ankimi.

Vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme.

III.1.8. Referuar arsyes së skualifikimit të operatorit ekonomik ankimues se afati i kontratave të qerave ka përfunduar, KPP gjykon se duhet të mbajë në konsideratë parashikimet ligjore të përcaktuara në Kodin Civil ku parashikohet shprehimisht se:

Neni 659 “Përmbajtja e Kontratës”

*Kontrata është veprimi juridik me anë të së cilës një ose disa palë krijojnë, ndryshojnë ose shuajnë një marrëdhënie juridike.*

Neni 660

*Palët në kontratë përcaktojnë lirisht përmbajtjen e saj, brenda kufijve të vendosura nga legjislacioni në fuqi. Konditat e nevojshme për qenien e kontratës janë: pëlqimi i palës që merr përsipër detyrimin, shkaku i ligjshëm në të cilin mbështetet detyrimi, objekti që formon lëndën e kontratës dhe forma e saj e kërkuar nga ligji.*

Neni 690

*Kontrata e lidhur rregullisht ka forcën e ligjit për palët. Ajo mund të priset ose të ndryshohet me pëlqimin e ndërsjellë të palëve ose për shkaqe të parashikuara me ligj.*

Neni 821



*Qiraja përtërihet në qoftë se, pasi të ketë mbaruar afati i saj, qiramarrësit i lihet në përdorim sendi i dhënë me qira pa kundërshtimin e qiradhënësit. Qiraja e re rregullohet me të njëjtat kushte si e mëparshmeja, por kohëzgjatja e saj caktohet si për qiratë me afat të caktuar.*

III.1.9. Në interpretim literal të dispozitave të sipërcituara, KPP gjykon se kontratat janë veprime juridike të cilat lidhen me vullnet të lirë të palëve të cilët mund të përcaktojnë lirisht përmbajtjen e saj brenda kufijve të lejuar me ligj. Kontratat lidhen duke respektuar disa kushte thelbësore të cilat janë shprehur qartësisht në ligj të tilla si pëlqimi i palës që merr përsipër një detyrim, të ketë një shkak të ligjshëm në të cilin mbështetet një detyrim, objekti i përcaktuar qartësisht si dhe aspekti formal që ka të bëjë me forma e kërkuar nga ligji. Pra mjafton që kontrata të përmbushë këto kondita të nevojshme për të qenë tërësisht e vlefshme dhe ligjore. Kontrata e lidhur ndërmjet palëve është një veprim juridik, e cila referuar Kodit Civil, është “shfaqja e ligjshme e vullnetit të personit fizik ose juridik, që synon të krijojë, të ndryshojë ose të shuajë të drejta ose detyrime civile”.

KPP gjykon se kontrata nuk përfundon vetëm në rastin e mbarimit të afatit të përcaktuar në të. Neni 690 parashikon se: Kontrata e lidhur rregullisht ka forcën e ligjit për palët. Ajo mund të priset ose të ndryshohet me pëlqimin e ndërsjellë të palëve ose për shkaqe të parashikuara me ligj. Në interpretim literal të kësaj dispozite KPP gjykon se edhe nëse kontrata mund të ketë parashikuar një afat më të gjatë ajo mund të priset në cdo kohë me pëlqim të palëve ose për shkak se njëra palë nuk përmbush detyrimet që rrjedhin prej saj e cila mund të detyrojë palën tjetër të kërkojë zgjidhjen e njëanshme të saj. Pra në këtë kuptim KPP gjykon se afati nuk është një garanci e dhënë njëherë e përgjithmonë që siguron autoritetin kontraktor se këto mjete do të jenë në dispozicion deri në përfundim të kontratës objekt prokurimi.

III.1.10. KPP gjykon se për autoritetin kontraktor është e rëndësishme që në momentin e zhvillimit të procedurës së prokurimit, operatori ekonomik të vërtetojë se disponon kapacitete në lidhje me eksperiencat e mëparshme, makineritë e pajisjet, punonjësit dhe personelin e duhur, etj., duke paraqitur dokumentacion të vlefshëm në datën e hapjes së procedurës duke realizuar edhe qëllimin e vendosjes së këtyre kritereve, për të kualifikuar një shoqëri që plotëson të gjitha kriteret dhe kërkesat e autoritetit kontraktor. KPP referuar datës së zhvillimit të procedurës 30.12.2019 gjykon se kontratat e sipërcituara me datë mbarimi 31.12.2019 janë të vlefshme në datën e zhvillimit të procedurës dhe ankimuesi dëshmon se disponon kapacitetet e nevojshme teknike për realizimin me sukses të kontratës objekt prokurimi. Fakti që afati i kontratave përfundon përpara përfundimit të kontratës objekt prokurimi, nuk duhet të penalizojë subjektin duke i kufizuar atij të drejtën për të marrë pjesë dhe rrjedhimisht për t’u kualifikuar në të gjitha procedurat të cilat mund të zhvillohen gjatë kësaj periudhe në vazhdim dhe mund të zgjasin përtej afatit të vlefshmërisë së kontratës.

Sa më sipër pretendimet e ankimuesit qëndrojnë.

III.2. Lidhur me arsyen e re të skualifikimit të pakomunikuar më parë ankimuesit njoftuar me shkresën kthim përgjigje më datë 20.01.2020 nga KSHA se “Gjithashtu ju sqarojmë se mjetet

e paraqitura nga ana juaj janë ATV që të gjitha mjetet ndërkohë në kriteret e vendosura në DT është kërkuar një mjet ATV dhe një mjet ATP. Në vlerësimin e bërë nga KVO ju është sqaruar që nuk plotësonit pikë 10 të DT ku kërkohet një mjet ATP nuk keni paraqitur asnjë dokument që të vërtetojë që plotësonit pikën 10 të DT”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.2.1. Në nenin 54 pika 3 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” të ndryshuar parashikohet se: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 54 të këtij ligji”. Në nenin 66 pika 3 të Vendimit nr.914 të Këshillit të Ministrave datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, parashikohet se “Pas mbylljes së seancës publike, komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kriteret për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Nëse është e nevojshme, komisioni i vlerësimit të ofertave kërkon sqarime nga ofertuesit, të cilat duhet të jenë me shkrim ose të reflektuara në procesverbal.” Ndërkohë në nenin 67 të Vendimit nr.914 të Këshillit të Ministrave datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, parashikohet se: “Në bazë të ofertave të pranuar, komisioni i vlerësimit të ofertave harton klasifikimin përfundimtar, i cili u komunikohet ofertuesve në kohën e përcaktuar në këto rregulla”. Në nenin 63, pika 1, 2, 5 dhe 6, të ligjit nr.9643, dt.20.11.2006 “Për prokurimin publik” është parashikuar: “Çdo person që ka ose ka pasur interes në një procedurë prokurimi dhe kur është dëmtuar ose rezikohet të dëmtohet nga një vendim i autoritetit kontraktor, i marrë në kundërshtim me këtë ligj, mund ta kundërshtojë vendimin.” “Ankesa i paraqitet, së pari, me shkrim, autoritetit kontraktor në fjalë brenda 7 ditëve nga dita e nesërme e punës kur ankimesi është vënë në dijeni ose duhet të ishte vënë në dijeni për shkeljen e pretenduar, sipas këtij ligji.” “Autoriteti kontraktor shqyrton ankesën dhe merr një vendim të arsyetuar brenda 7 ditëve pas marrjes së ankesës, të cilin duhet t’ia njoftojë ankuesit jo më vonë se në ditën vijuese të punës”. Ndërsa në pikën 6 të kësaj dispozite është përcaktuar se: “Nëse autoriteti kontraktor nuk shqyrton ankesën brenda afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të këtij neni, ose e refuzon atë, ankimesi mund të paraqesë një ankesë me shkrim në Komisionin e Prokurimit Publik brenda 10 ditëve nga dita e nesërme e punës, pas përfundimit të afatit kohor, të përcaktuar në pikën 5 të këtij neni, ose, në rast se ankesa nuk pranohet nga autoriteti kontraktor, që nga dita kur ankuesi është njoftuar nga autoriteti kontraktor. Një kopje me shkrim i dërgohet detyrimsht edhe autoritetit kontraktor.”

Në kreun X “Shqyrtimi i Ankesave”, neni 78, pika 6 i Vendimit nr.914 të Këshillit të Ministrave datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar parashikohet se “Për shqyrtimin e ankesave, autoriteti kontraktor ndjek hapat e mëposhtëm:  
a) Titullari i autoritetit kontraktor ia ngarkon çështjen një komisioni të përbërë nga 3 (tre) persona, për të shqyrtuar ankesën dhe për të dhënë një vendim. Përfundimisht, në rast të mungesës së personelit, titullari i autoritetit kontraktor ia ngarkon çështjen për shqyrtim 1

*(një) zyrtari të vetëm. Komisioni/zyrtari i ngarkuar është përgjegjës për vendimin e dhënë në përfundim të shqyrtimit të ankesës. Anëtarët e komisionit/zyrtari i ngarkuar nuk duhet të kenë marrë pjesë në marrjen e vendimit, për të cilin është paraqitur ankesa. Në rast se ankimi lidhet me dokumentet e tenderit, titullari i autoritetit kontraktor mund t'ia ngarkojë shqyrtimin e ankesës komisionit të vlerësimit të ofertave.” Në nenin 78, pika 6 gërma “ç” të Vendimit Nr.914 të Këshillit të Ministrave dt.29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar parashikohet se: [...]Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, komisioni/zyrtari i ngarkuar për shqyrtimin e saj mund të marrë vendim për refuzimin ose pranimin e ankesës, i cili i komunikohet menjëherë titullarit të autoritetit kontraktor. Në rastin kur ankesa është pranuar, titullari i autoritetit kontraktor i adreson vendimin për zbatim komisionit të vlerësimit të ofertave.*

III.2.2. Komisioni i Prokurimit Publik thekson faktin se përcaktimi i procedurave dhe afateve të caktuara procedurale në LLP dhe Rregullat e Prokurimit Publik, duke filluar nga afati për përgatitjen e ofertës, afati i shqyrtimit të ofertave, afati i ankimit etj, përfaqësojnë garanci juridike për palët e interesuara. Parimi i ligjshmërisë është ndër parimet kryesore të veprimtarisë së organeve të administratës publike, (*Neni 4 i K.pr. Administrative*). Gjithashtu, ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurave të prokurimit, parashikuar nga *lex specialis* LPP, në neni 2 të tij janë ato të mos diskriminimit, transparencës dhe barazisë. Tërësia e elementëve të mësipërm lidhet ngushtësisht me elementë të ligjshmërisë së vendimeve të organeve të administratës publike. Në interpretim interpretim sistematik (domethënjen e drejtë të normës juridike duke e vënë në lidhmëri me normat e tjera brenda sistemit juridik), Komisioni i Prokurimit gjykon se ligjvënësi ka ndarë qartësisht dy momentet procedurale atë të vlerësimit të ofertave nga ana e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave dhe momentin e dytë të garancisë procedurale të mbrojtjes së interesave të ligjshme të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit, atë të ankimit administrativ pranë autoritetit kontraktor ( rishikimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave) nga vetë autoriteti kontraktor por nga një trupë e re, e cila nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesave me komisionin e vlerësimit të ofertave, shqyrtimin e ankesave nga K.Sh. A ( Komisioni i Shqyrtimit të Ofertave). Normativa e mësipërme, parashikuar nga neni 63 i ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*” të ndryshuar, rregullon të drejtën e personave të interesuar në një procedurë prokurimi për të paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe më pas pranë Komisionit të Prokurimit Publik në kuadrin e rishikimit administrativ të kësaj procedure, e thënë ndryshe, legjitimitimin për të vënë në lëvizje dhe investimin e autoritetit kontraktor për rishikimin e vendimit të KVO-së. Në rastin konkret KPP konstaton se Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave gjatë shqyrtimit administrativ të ankesës ka shtuar arsye të reja skualifikimi në tejkalim të kompetencave që parashikon ligji.

Sa më sipër Komisioni gjykon se arsyeja e re e skualifikimit dhënë nga Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave, në tejkalim të kompetencave që u jep shprehimisht neni 78 i VKM nr.914 datë 29.12.2014 nuk sjellin asnjë pasojë mbi operatorin ekonomik ankimues e si të tilla nuk merren në shqyrtim nga KPP.

III.3. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “MC Catering” shpk mbi kundërshtimin e kualifikimit të ofertës së operatorit ekonomik “Nelsa” shpk me argumentin se “OE Nelsa shpk nuk disponon Licencë lëshuar nga QKB me kategoritë e mëposhtme: *Kategoria II.1.A (1) Prodhimi dhe /ose tregëtimi i ushqimeve në emër të tij për objektin e prokurimit. Në faqen zyrtare të QKB operatori ekonomik Nelsa nuk disponon në emër të tij QKL kategoria II.1.A për objektin e prokurimit, disponon për furrë buke dhe fruta perime por jo për mish e cila automatikisht e bën ofertues të pasuksesshëm , kjo edhe sipas rekomandimit të APP nr.10181 datë 19.11.2018 mbi hartimin e kriterëve të vecanta për kualifikim dhe specifikimeve teknike për prokurimin e produkteve ushqimore pika III.Hartimi i kriterëve të vecanta për kualifikim pika a: Në objektet e prokurimit për prodhim/përpunim dhe shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz operatori ekonomik ofertues duhet të disponojë licencë kategoria II.1.A.1 Prodhim , përpunim shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz të lëshuar nga QKB pika a.1 Për të plotësuar këtë kriter për kualifikim operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë licencën kategoria II.1.A Prodhim , përpunim, shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz në emër të tij pasi licenca duhet ti përkasë operatorit ekonomik të intersuar të ofertojë për procedurën e prokurimit të shpallur nga autoriteti kontraktor”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,*

III.3.1. Në shtojcën 8 “Kriteret e vecanta të kualifikimit” pika 2.3 “Kapaciteti teknik” të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë :

*Operatori Ekonomik pjesëmarrës duhet të disponojë:*

*Licence lëshuar nga Qendra Kombetare e Biznesit (QKB) me kategoritë e mëposhtme:*

*Kategoria: II.1.A (1) Prodhimi dhe/ose tregëtimi i ushqimeve.*

*Licenca duhet të jetë në emër të operatorit ekonomik pjesëmarrës në procedurë pasi duhet ti përkasë operatorit të interesuar te ofertojë për procedurën e prokurimit të shpallur nga Autoriteti Kontraktor.*

III.3.2. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton se operatori ekonomik ankimues ”Nelsa” shpk në përmbushje të kriterit sa më sipër ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

- Kontratë Furnizimi Nr.9621 rep nr.6683 Kol datë 14.12.2019 lidhur ndërmjet shoqërisë ”Nelsa” shpk në cilësinë e porositësit dhe shoqërisë ”Kazazi Meat” shpk me Licencë Kodi II.1.A 1 në cilësinë e Furnizuesit me objekt ”furnizimin e porositësit me Mish të Freskët” për realizimin e kontratave me autoritetin kontraktues në rast të shpalljes fitues.
- Licencë me Kod II.1.A1 për subjektin ”Kazazi Meat” shpk me përshkrim veprimtarie Prodhim, përpunim e shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz (Thertore).

III.3.3. Referuar kriterëve kualifikuese të procedurës së prokurimit objekt ankimi KPP konstaton se autoriteti kontraktor për procedurën e prokurimit objekt ankimi ka parashikuar

se shoqëritë pjesëmarrëse duhet të paraqesin dokumenatacionin ligjor përkatësisht Licence leshuar nga Qendra Kombetare e Biznesit (QKB) me kategoritë e mëposhtme: Kategoria: II.1.A (1) Prodhimi dhe/ose tregtimi i ushqimeve. Në kriter është parashikuar gjithashtu se Licenca duhet të jetë në emër të operatorit ekonomik pjesëmarrës në procedurë pasi duhet ti përkasë operatorit të interesuar te ofertojë për procedurën e prokurimit të shpallur nga Autoriteti Kontraktor.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në sistemin e prokurimeve elektronike nga operatori ekonomik “Nelsa” shpk rezulton se dokumentacioni i kërkuar në rastin konkret Licenca me kategori II.1.A 1 nuk disponohet nga ofertuesi i kualifikuar (operatori ekonomik pjesëmarrës) në këtë procedurë prokurimi “Nelsa” shpk por dokumenti është në emër të personit të tretë “Kazazi Meat” shpk subjekt i cili sikundër pasqyruar më sipër ka me ofertuesin marrëdhënie kontraktuale furnizimi.

III.3.4. Në interpretim të kriterëve të kualifikimit të përcaktuara nga autoriteti kontraktor e njëherazi në respekt të nenit 46 pika 1 gërma “a” dhe “b” të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, në të cilin parashikohet se: *“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese: a) kualifikimi profesional: çdo operatori ekonomik i kërkon licencat profesionale, industriale apo tregtare, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore, përveprimtaritë e kërkuara dhe për të cilat do të lidhet kontrata; b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”*, KPP gjykon se licenca e paraqitur nga operatori ekonomik “Nelsa” shpk e cila nuk është në emër të këtij të fundit nuk mund të konsiderohet e vlefshme në këtë procedurë prokurimi. KPP gjykon se plotësimi i kërkesave për kualifikim në një procedurë prokurimi shtrihet vetëm ndaj operatorëve pjesëmarrës dhe në asnjë rast, operatorët ekonomikë pjesëmarrës nuk mund të përmbushin kapacitetet teknike me anë të dokumentacionit të subjekteve të tjerë juridikë. Dorëzimi i dokumentacionit të një subjekti tjetër i cili nuk është pjesëmarrës në procedurën e prokurimit dhe as nuk shfaqet në cilësinë e njërit prej anëtarëve të bashkimit të operatoreve nuk mund të konsiderohet i vlefshëm duke u paraqitur si dokumentacion i vetë pjesëmarrësit. KPP gjykon se përdorimi i kapacitetit teknik të subjekteve të tjerë juridikë në kuadër të përfitimit të fondeve publike referuar ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” të ndryshuar, pranohet në rastet e paraqitjes së ofertës në cilësinë e bashkimit të operatorëve ekonomikë në zbatim të nenit 74 të Vendimit nr.914 datë 29.12.2014 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar.

III.3.5. Gjithashtu, në nenin 75 të Vendimit Nr.914 datë 29.12.2014 të Këshillit të Ministrave, parashikohet se “ 1. Autoriteti kontraktor mund të lejojë nënkontraktimin për realizimin e një

*pjesë të kontratës. Në asnjë rast, kontraktorët nuk mund t'ua transferojnë kontratën palëve të treta. Autoriteti kontraktor lejon në veçanti nënkontraktimin për të nxitur pjesëmarrjen e operatorëve të vegjël e të mesëm ekonomikë.*

*2. Në dokumentet e tenderit duhet të përcaktohet qartë nëse lejohet ose jo nënkontraktimi, si dhe nëse autoriteti kontraktor do t'i bëjë pagesa të drejtpërdrejta nënkontraktorit.*

*3. Në asnjë rast nënkontraktimi nuk duhet të tejkalojë 40% të vlerës së kontratës.*

*4. Me dorëzimin e ofertave, ofertuesit duhet të deklarojnë punët/shërbimet/mallrat ose një pjesë të tyre që ata kanë qëllim të nënkontraktojnë, në rast se shpallen fitues, si dhe emrin e nënkontraktorit.*

*5. Përpara lidhjes së kontratës, ofertuesi i shpallur fitues duhet t'i dorëzojë autoritetit kontraktor një kopje të noterizuar të marrëveshjes së nënkontraktimit dhe dëshminë e kualifikimeve e të kërkesave teknike të nënkontraktorit, në mënyrë të tillë që autoriteti kontraktor të mund të miratojë nënkontraktimin. Komisioni i vlerësimit të ofertave vlerëson nëse nënkontraktori plotëson kërkesat e nenit 45 të LPP-së, si dhe zotëron kualifikimet teknike për pjesën e punës e të shërbimeve që do të kryejë ose për mallrat që do të furnizojë.*

*6. Në rast të mosplotësimit nga nënkontraktori të kriterëve të kërkuara, autoriteti kontraktor vijon me lidhjen e kontratës me operatorin ekonomik të shpallur fitues.*

*7. Gjatë ekzekutimit të kontratës autoriteti kontraktor duhet të kontrollojë nëse pjesa e kontratës, e marrë përsipër për t'u realizuar nga nënkontraktori, po realizohet nga ky i fundit. Në rast se autoriteti kontraktor konstaton se nënkontraktori nuk po realizon pjesën e kontratës së marrë përsipër i kërkon kontraktorit kryesor të ndërpresë nënkontraktimin dhe të vijojë me zbatimin e kontratës.”*

Referuar dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik i kualifikuar në asnjë moment nuk rezulton që nga kjo e fundit të jetë marrë konfirmimi i autoritetit kontraktor lidhur me ndonjë marrëveshje të mundshme nënkontraktimi, për më tepër që në dokumentat e procedurës së prokurimit objekt ankimi është përjashtuar mundësia e nënkontraktimit. Në këtë kuptim KPP gjykon se operatori ekonomik “Nelsa” shpk është në kushtet e mospërbushjes së kriterit kualifikues lidhur me disponimin e Licencës me kategori II.1.A 1.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

III.4. Lidhur me pretendimet e tjera të operatorit ekonomik ankimues “MC Catering” shpk mbi skualifikimin e operatorit ekonomik “Nelsa” shpk Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se nuk do të merren në shqyrtim pasi, referuar gjykimit mësipër gjendja faktike dhe juridike e operatorit ekonomik “Nelsa” sh.p.k. do të ndryshojë duke u skualifikuar nga procedura në fjalë, e rrjedhimisht duke përmbushur interesin e ankimuesit.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar dhe nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri

## Vendos

1. Të pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “MC Catering” sh.p.k për procedurën e prokurimit “*Kërkesë për Propozime*”, me nr.REF-46468-12-18-2019, me objekt “*Blerje Mish për kafshët e Parkut Zoologjik*”, me fond limit 5 382 534 lekë pa tvsh, zhvilluar në datën 30.12.2019 nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Parqeve dhe e Rekreacionit.
2. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së mbi skualifikimin e operatorit ekonomik “MC Catering” sh.p.k, duke e kualifikuar atë.
3. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së mbi kualifikimin e operatorit ekonomik “Nelsa” sh.p.k, duke e skualifikuar atë.
4. Autoriteti kontraktor, brenda 10 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
5. Ngarkohet zyra e financës të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “MC Catering” shpk.
6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Nr.81 Protokolli; Datë 24.01.2020**

### **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Nënkryetar**  
**Enkeleda Bega**

**Anëtar**  
**Vilma Zhupaj**

**Anëtar**  
**Lindita Skeja**

**Anëtar**  
**Merita Zeqaj**

**Kryetar**  
**Evis Shurdha**

